



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prinjenje/Prodato Received/Delivery	13.04.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHOC	3507/2023		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.433/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.433/2023 të datës 06.10.2022 të parashtruar nga ankuesja _____ ndër organit të punësimit Ministria e Zhvillimit Rajonal, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 d.f. nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.433/2023 e datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja, _____ punësuar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, me datë 28.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2154/2023 e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.433/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mos shqyrtimit të ankesës së datës 05.01.2023 ankueses nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e mos shqyrtimit të ankesës së saj të datës 05.01.2023 është vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, ndërsa e njëjta kërkon që këshilli të aprovojë ankesën e saj ndërsa të detyrojë Ministrinë e Zhvillimit Rajonal të iniciojë procedurën disiplinore sipas ankesës së saj.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 06.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë e ankuesit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, ndërsa me datën 20.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër te protokollit 2154/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 27.02.2023 dërguar nga ankuesja për Këshillin; Ankesën e ankueses të datës 05.01.2023 me numër:01; E-mailin e datës 20.12.2022 dërguar nga Y.Ç për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej katër faqesh; -mailin e datës 20.12.2022 dërguar nga Y.Ç për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej tetë faqesh; Procesverbalin e datës 28.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.03.2023; Aktin e emërimit të ankueses i datës 07.12.2023 me shifër AE.Nr.4/2021; **Konkursin** e datës 26.04.2021; E-mailin e datës 01.02.2023 dërguar nga A.A-Xh për B.K; ; E-mailin e datës 03.02.2023 dërguar nga A.A-Xh për ankuesen; E-mailin e datës 03.02.2023 dërguar nga ankuesja për A.A-Xh; E-mailin e datës 06.02.2023 dërguar nga B.K për ankuesen; E-mailin e datës 07.02.2023 dërguar nga ankuesja për B.K.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses _____, është **e pabazuar** sepse:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 07.12.2021 është e punësuar në pozitën e punës "*Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm*" pranë Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, ndërsa ankuesja më shkresën e përbashkët-ankesën e datës 05.01.2023 me numër:01 i është drejtuar Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Komisionit Disiplinor kundër Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Zhvillimin Rajonal me arsyetimi se i njëjti është sjell me ankuesen në kundërshtim me kodin e etikës në punë.

Komisioni Disiplinor përmes e-mailit të datës 01.02.2023 e njofton ankuesen se në parim Komisioni Disiplinor nuk ka mandat ligjor të shqyrtoj ankesa të nëpunësve civil sipas kërkesës së tyre duke iu referuar ankesës së ankues të datës 05.01.2023, me sugjerimin se në rastin konkret duhet të vihet në dijeni udhëheqësi i drejtpërdrejtë i shkelësit të pretenduar, gjegjësisht Sekretari i Përgjithshëm i cili më pastaj bënë kualifikimi e shkeljes disiplinore dhe nëse e vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore që të veprohet sipas dispozitave të ligjit material e procedon rastin në Komision Disiplinor. Tutje, me datë 06.02.2023 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal i përgjigjet ankueses se çështja e ngritur nuk mund të trajtohet në kategorinë e adresuar me kërkesën që të dy palët me solo consensus (vullnet të palëve) te pajtohen që ky komunikim të mos vazhdoj përtej aspektit profesional, me zotimin se një kërkesë të tillë do ta përcjellë edhe tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Zhvillim Rajonal.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses nëse institucionin punëdhënës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material pasi që nuk e ka shqyrtuar ankesën e ankueses me qëllim të inicimit të procedurës disiplinore me kërkesën që Këshilli ta

detyrojë Ministrinë e Zhvillimit Rajonal të inicioj një procedurë të tillë disiplinore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 7 paragrafi 5 dhe 6 Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *“5. Në rast se shkelja klasifikohet sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafët 4.1 deri 4.4 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë fillon procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit. 6. Në rast kur shkelja kualifikohet sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë kërkon nga komisioni disiplinor të fillojë procedurën disiplinore sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 të Ligjit”* ndërlidhur me nenin 6 paragrafi 1 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësit civil të institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet të raportojnë atë me shkrim Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen”,* prandaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, mos shqyrtimi i ankesës nga ana e Komisionit Disiplinor lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore sipas kërkesës së drejtpërdrejtë të ankueses është veprim i drejtë dhe i bazuar në dispozitat e lartcekura të kësaj rregullore, ngase në rastin konkret sipas autorizimeve ligjore mbetet në diskrecion të Sekretarit të Përgjithshëm që t’i vlerësoj kërkesat e nëpunësve civil për iniciimin e procedurës disiplinore nëse të njëjtat i plotësojnë parakushtet e përcaktuara të shkeljes së rëndë të detyrave të punës sikurse përcaktohet me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafët 3.1 deri 3.11 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, me qëllim të adresimit tek Komisioni Disiplinor.

Po ashtu, në mbështetje të nenit 7 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *“Nëse njoftimi i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore, duke e arsyetuar me shkrim mos fillimin e procedurës dhe për këtë e njofton paraqitësin e shkeljes së pretenduar përmes njoftimit formal sikurse që përcaktohet me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative”* dhe vlerësimin të Sekretarit të Përgjithshëm përmes shkresës së datës 06.02.2023 dërguar përmes e-mailit në adresë të ankueses, Kolegji i Këshillit ka arritur në përfundimin se i njëjti sjellën e palëve të përfshira nuk e kategorizon në kuptim të shkeljeve të rënda disiplinore prandaj rastin nuk e ka iniciuar për procedurë disiplinore pranë Komisionit Disiplinor, dhe mbi këtë bazë konstatohet fakti se dispozita në fjalë ia ka njohur të drejtën e vlerësimin nëse një informatë e marrë rezulton me shkelje disiplinore apo ka elemente të përgjegjësisë së rëndë disiplinore.

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankueses se Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar të veprojë konform 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektivi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit”* dhe ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret ky paragraf nuk mund të gjejë zbatim për shkak se nga përmbajta e ankesës së datës 05.01.2023 është arritur në përfundimin se kërkesa për iniciimin të procedurës disiplinore është bërë për çështje të sjelljeve ndër personale dhe fjalorit të përdorur ndërmjet palëve, madje një pretendim apo veprim i tillë është në kundërshtim edhe me frymën ligjore të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që palët duke pasur pozita në hierarki institucionale, diskrecionin e dhënë sipas ligjit nuk mund të ushtrojnë në mënyrë jo të ligjshme, gjegjësisht në rastin konkret ankuesja nuk mund të iniciojë procedurë disiplinore ndaj një nëpunësi civil duke u thirrur në cilësi të Udhëheqëses së

Divizionit të Auditimit të Brendshëm për çështje të cilat hyjnë në fushën sjelljeve personale të palëve të përfshira.

Prandaj nga se i tha si më lartë, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, në mbështetje të paragrafit 9 të nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ndërlidhur me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë të cilat u analizuan dhe pasqyruan si më lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson se është jashtë mandatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit material dhe se nuk mund të detyrojë zyrtarin më të lartë administrativ të institucionit që t'i shqiptojë një nëpunësi civil masë disiplinore, gjegjësisht të iniciojë procedurë disiplinore, prandaj nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi ankesa e ankueses është e pabazuar, ndërsa theksohet fakti se meqenëse nuk ka akt administrativ të nxjerrë i cili është goditur përmes ankesës së datës 28.02.2023 apo nuk është kërkuar nxjerrja e një akti administrativ sipas fuqisë së ligjit, mirëpo është kërkuar iniciimin i një procedurë disiplinore, andaj nisur nga ky fakt Kolegji i Këshillit nuk ka mundur të lëshohet në konstatimin nëse palët në procedurë kanë kryer shkelje disiplinore, mirëpo ka shqyrtuar dhe konstatuar aspektin procedural lidhur me parimet e përgjithshme të inicimit të një procedure disiplinore, prandaj nisur nga ky fakt u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.433/2023

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunëtor Profesional

Malsore Gashi-Bajraktari



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.